



Pranuar / Dorezuar Prilimeno / Predato Received / Delivered	03 . 11 2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUMSHOK	6684 / 2022		119



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.604/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca, anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A. Nr. 665/2021, të datës 16.09.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.604/2019 të datës 04.10.2019 të ankuesit

kundër organit të punësimit Komuna e Skenderajt, në çështjen juridike “kompensimi material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 03.11.2022, mori këtë;

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A. Nr. 604/2018 e datës 04.10.2019, e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Vendimi me Nr. 02-120/01-0047893/19, i datës 30.08.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Skenderajt.

A r s y e t i m

Udhëheqësi i Personelit i Komunës së Skenderajt, me datë 04.07.2019, me numër 118-02-0040730/19/2019 ka nxjerr vendim lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, për nëpunësin civil Adem Meta, duke i njohur të drejtën e një pagë përcjellëse në rastin e pensionimit.

Ankuesi me datën 31.07.2019, me numër protokoli 02-120/01-0047593/19/2019 me ankesë i është drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, në Komunën e Skenderajt.

Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Skenderajt me datën 30.08.2019, me numër 02-120/01-0047893/19, ka nxjerr vendim me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar në ligj.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin me numër 02-120/01-0047893/19, të datës 30.08.2019 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Skenderajt, në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, me datë 04.10.2019 parashtron ankesë, me pretendimet ankimore se organi i punësimit me rastin e pensionimit të tij duhet ti bëjë pagesën e tri (3), pas arritjes së moshës së pensionimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 05.11.2019, me numër protokoli 5202/2019, ka njoftuar ankuesin Adem Meta, se nuk mundë të shqyrton dhe vendose lidhur me ankesën A. Nr. 604/2019, të datës 04.10.2019, për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, duke e udhëzuar ankuesen që ti drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 05.11.2019, të Këshillit ka hapur konfliktin administrative, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 16.09.2022, A. Nr. 665/2021, ka nxjerr Aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit me të cilin ka anuluar njoftimin e datës 05.11.2019, duke e obliguar Këshillin që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A. Nr.604/2019, të datës 04.10.2019 të ankuesit

Administrimi i Provave, Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 604/2019 e parashtruar më datë 04.10.2019, me numër protokoli 4649/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shënimin Civil të Kosovës; Aktgjykimit A. Nr. 665/2021, të datës 16.09.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative Vendimi i datës 04.07.2019, për pensionimin e nëpunësit civil Ankesa e datës 31.07.2019, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi i datës 30.08.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Urdhër obligim për pagesë; Njoftimi i datës 05.11.2019, i Këshillit; Përgjigje në ankesë e datës 21.10.2019, me numër protokoli 4952/2019, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar së Udhëheqësi Personelit i Komunës së Skenderajt, ka nxjerr vendimin e datës 04.07.2019, e numër protokoli 118/02-0040730/19 për përfundimit e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit me të cilin i është njohur e drajta e një page të fundit pas moshës së pensionimit, sipas dispozitave ligjorë ne fuqi, është në pajtim nenin 19, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores 33/2012, për Shtesat në pagë dhe kompensimet të Tjera të Nëpunësve Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon së organi i punësimit Komuna e Skenderajt, duhet të bëjë pagesën në vlerën e tri (3) pagave me rastin pensionimit, sipas kontratës kolektive.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilin janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesit dhe rrjedhimisht ka konstatuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr. 38/2014 më datë 18.06.2014, ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhë jo më shumë se tri (3) vite, respektivisht deri më datë 31.12.2017. Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i MPKK-së, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, pas datës 31.12.2017.

Andaj, duke marr parasysh konstatimin se ankuesi ka arritur moshën e pensionimit me datë 15.07.2019, në kohën kur Kontrata e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk ka qenë në fuqi, dhe rrjedhimisht nuk ka prodhuar pasoja juridike, Kolegji konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit për njohjen e të drejtës së pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe pagave jubilarë, në mbështetje të nenit 52 dhe 53 të Kontratës së Përgjithshme Kolektive, eshët i pa bazuar.

Kolegji në shkresa të lëndës ka gjetur Urdhër Obligimin për Pagesë të datës 29.07.2019 ku shihet se ankuesit i është kompensuar një pagë mujore e njëhershme në vlerën e pagesë së fundit, si pagë përcjellëse, gjegjësisht 522.87 euro, siç përcaktohet me nenin 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe dispozitat e nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë.

Andaj, Kolegji konstaton se organi i punësimit duke i njohur të drejtën ankuesit për realizimin e një pagë mujore të njëhershme në vlerën e pagesë së fundit, dhe të drejtën e kompensimit në emër të shpërblimit jubile sipas dispozitave të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, ka zbatuar drejt ligjin material, dhe rrjedhimisht Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Skenderajt, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 02-120/01-0047893/19, i datës 30.08.2019 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe drejt ka zbatuar ligjin material duke vepruar kështu në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit në këtë kuptim janë të pa bazuara.

Andaj pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr.604/2019

Rushit Kajtazi
[Signature]
Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

Ankuesit;
Gjyqtarit [redacted] në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Administrative
Kryetarit të Komunës së Skenderajt;
Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Skenderajt
Arkivit të KPMSHCK-së